

Vendim nr. 218 datë 02.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Marsida Xhaferllari, Anëtare
Marjana Semini, Anëtare

në datën 02.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 15 (E) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: ENRIK (ELTON) MAMLI, përfaqësuar nga avokate Donika Prela, me akt përfaqësimi.

TOM MAMLI, përfaqësuar nga avokate Eda Grimci, me akt përfaqësimi.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 214-14, datë 01.02.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin; nr. 2475, datë 21.11.2018 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2024-450, datë 12.03.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 28 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin ka paraqitur para kësaj gjykate kërkesën për gjykimin e procedimit penal në ngarkim të të pandehurve Tom Mamli, Enrik (Elton) Mamli (*kërkuessit*) dhe disa shtetasve të tjerë, të akuzuar për veprat penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, në mënyrë të rrezikshme për jetën e shumë personave, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 79, shkronja “ë” edhe 25 të Kodit Penal (KP) dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municioneve luftarake”, të parashikuar nga neni 278 i KP-së.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin nr. 214-14, datë 01.02.2018, ka vendosur: (i) ndryshimin e kualifikimit ligjor të veprës penale për kërkuesin Tom Mamli, nga vepra penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, në mënyrë të rrezikshme për jetën e shumë personave, e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 79, shkronja “ë” dhe 25 i KP-së, në veprën penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, në mënyrë të rrezikshme për jetën e shumë personave” dhe dënimin e tij me 25 vjet burgim; (ii) deklarinin fajtor për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, të parashikuar nga neni 278/1 i KP-së dhe dënimin e tij me 4 vjet burgim. Përfundimisht, kërkuesi Tom Mamli është dënuar me 29 vjet burgim. Në dispozitivin e vendimit gjykata është shprehur se vuajtja e dënimit fillon nga data 26.02.2016, në të cilën kërkuesi është arrestuar dhe dënimi të vuhet në një burg të sigurisë së lartë. Po sipas dispozitivit të vendimit ndalohet zbatimi i nenit 64 të KP-së për lirimin e tij para kohe me kusht për të gjithë kohëzgjatjen e dënimit.

3. Për kërkuesin Enrik (Elton) Mamli gjykata e shkallës së parë ka vendosur: (i) ndryshimin e kualifikimit ligjor të veprës penale nga vepra penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, në mënyrë të rrezikshme për jetën e shumë personave, e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 79, shkronja “ë” dhe 25 të KP-së, në veprën penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, në mënyrë të rrezikshme për jetën e shumë personave, të mbetur në tentativë, të parashikuar nga nenet 79, shkronja “ë” dhe 22 të KP-së dhe dënimin e tij me 20 vjet burgim; (ii) deklarinin e tij fajtor për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, të parashikuar nga neni 278/1 i KP-së dhe dënimin me 4 vjet burgim. Përfundimisht, kërkuesi është dënuar me 22 vjet burgim. Në dispozitivin e vendimit gjykata është shprehur se vuajtja e dënimit për të fillon në datën 23.09.2015, në të cilën ai është arrestuar dhe dënimi të vuhet në një burg të sigurisë së lartë. Po sipas dispozitivit të vendimit ndalohet zbatimi i nenit 64 të KP-së për lirimin e tij para kohe me kusht për gjithë kohëzgjatjen e dënimit.

4. Mbi bazën e ankimit të prokurorit dhe kërkuesve, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2475, datë 21.11.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

5. Mbi bazën e rekurseve të prokurorit dhe kërkuesve, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-450, datë 12.03.2024, ka vendosur mospranimin e tyre, pasi nuk përmbanin asnjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), ndaj nuk ka shkaqe për cenimin e vendimit të gjykatës së apelit.

6. Në datën 10.07.2024 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar me dokumentet e kërkuara, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 23.07.2024.

II

Pretendimet e kërkuesve

7. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se u është cenuar:

7.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të:

7.1.1. *Së drejtës së aksesit në gjykatë*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesve, nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura në të.

7.1.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat e faktit nuk kanë analizuar rrethanat e çështjes dhe veprimet e kryera nga to bien në kundërshtim flagrant me ligjin penal, por edhe me atë procedural penal për sa i përket institutit të çmuarjes së provave sipas neneve 152 dhe 432, pikat 1 dhe 2, të KPP-së. Në vendimin për mospranim të rekursit, Kolegji Penal, në dhomën e këshillimit, është mjaftuar me një arsyetim *de plano*, i cili edhe pse nga Gjykata dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) konsiderohet i mjaftueshëm, vlen vetëm për rastet kur procesi në gjykatat e zakonshme nuk shfaq probleme. Në rast të kundërt vihet në dyshim nga pikëpamja kushtetuese edhe vetë vendimi i Gjykatës së Lartë. Ajo gjykatë duhej të investohej në shqyrtimin e pretendimeve për shkeljet procedurale të ngritura në rekurs, të mbante qëndrim të shprehur lidhur me to dhe jo të mjaftohej vetëm me interpretimin dhe zbatimin e nenit 152 të KPP-së, duke kufizuar artificialisht pretendimet e paraqitura në rekurs. Kolegji Penal nuk është shprehur dhe nuk u ka dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të

kërkuesve që referojnë në thelb mosrespektimin e parimeve të prezumimit të pafajësisë, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, si dhe çështjes së çmuarjes të provave për vërtetimin e fajësisë së kërkuesve në procesin penal të zhvilluar në gjykatat e faktit.

7.2. *Parimi i prezumimit të pafajësisë*, i parashikuar nga neni 30 i Kushtetutës, pasi gjykatat e faktit janë bazuar në indicie dhe jo në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për deklarimin fajtorë të kërkuesve. Edhe në rrjedhën kronologjike të veprimeve të analizuara nga to nuk ekziston ndonjë provë e drejtpërdrejtë që lidh kërkuesit me veprën penale të kryer. Nga përmbajtja e vendimeve të kundërshtuara, më së shumti, ekziston një dyshim dhe për të justifikuar vendimet e tyre, gjykatat e faktit i kanë çmuar pretendimet e kërkuesve si të pabazuara, duke e kaluar barrën e provës nga organi i akuzës te kërkuesit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesve

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

9. Në këtë këndvështrim, Kolegji vlerëson se kërkuesit, si individë, legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, sepse janë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë kanë interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

10. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “P”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar (*shih vendimet nr. 11, datë 28.02.2024; nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuessit kanë kundërshtuar vendimet gjyqësore të të tria shkallëve të gjyqimit, ku vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka përmbyllur në themel procesin gjyqësor të iniciuar prej tyre. Në këtë situatë, Kolegji vlerëson se ata nuk kanë më mjete të tjera ankimi ndaj vendimeve të kundërshtuara dhe, për rrjedhojë, kanë përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

12. Kërkuessit legjitimohen edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 12.03.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 10.07.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

13. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuessit kanë pretenduar se vendimet e kundërshtuara u kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të të drejtës së aksesit në gjykatë, standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, si dhe parimit të prezumimit të pafajësisë, të garantuar nga neni 30 i Kushtetutës, të cilat vlerësohet se *prima facie* përfshihen në juridiksionin kushtetues dhe do të analizohen në vijim.

14. Duke pasur parasysh thelbin e pretendimeve të kërkuessve dhe mënyrën se si janë parashtruar në ankimin kushtetues individual, Kolegji çmon që pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë ta analizojë të lidhur me pretendimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

15. Kërkuessit kanë pretenduar se gjykatat e faktit nuk kanë analizuar rrethanat e çështjes dhe veprimet e kryera nga to bien në kundërshtim flagrant me ligjin penal, por edhe me atë procedural penal, për sa i përket institutit të çmuarjes së provave sipas neneve 152 dhe 432, pikat 1 dhe 2, të KPP-së. Sipas kërkuessve, në vendimin për mospranimin e rekursit, Kolegji Penal, në dhomën e këshillimit, është mjaftuar me një arsytim *de plano*, i cili edhe pse nga Gjykata dhe GJEDNJ-ja konsiderohet i mjaftueshëm, vlen vetëm për rastet kur procesi

në gjykatat e zakonshme nuk shfaq probleme. Në rast të kundërt vihet në dyshim nga pikëpamja kushtetuese edhe vetë vendimi i Gjykatës së Lartë. Kërkuesit kanë parashtruar, gjithashtu, se Kolegji Penal nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs që referojnë në thelb mosrespektimin e parimeve të prezumimit të pafajësisë, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, si dhe çështjes së çmuarjes të provave për vërtetimin e fajësisë së kërkuesve në procesin penal të zhvilluar në gjykatat e faktit. Ky kolegji duhet të investojë në shqyrtimin e pretendimeve për shkeljet procedurale, të mbante qëndrim të shprehur lidhur me to dhe jo të mjaftojë vetëm me interpretimin dhe zbatimin e nenit 152 i KPP-së, duke kufizuar artificialisht pretendimet e paraqitura në rekurs.

16. Në jurisprudencën e saj Gjykata e ka vlerësuar të drejtën e aksesit si një të drejtë të individit jo vetëm për të filluar një proces, por edhe për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj, të arsyetuar, për pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr.17, datë 24.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata ka pohuar se shqyrtimi i çështjes nga Kolegjet e Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore (*shih vendimet nr. 12, datë 19.03.2015; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Po kështu, Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga neni 42 i Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, i cili përkon edhe me detyrimin e gjykatave për të arsyetuar vendimet, sipas nenit 142, pika 1, të Kushtetutës. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 42, datë 19.09.2023; nr. 10, datë 04.03.2021; nr. 18, datë 15.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

Ndërsa në lidhje me vendimet e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë, Gjykata ka pohuar se ato mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e tyre (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, detyrimi për garantimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 17, datë 23.03.2023; nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 34, datë 13.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Duke iu kthyer rastit konkret, Kolegji konstaton se gjykata e shkallës së parë i ka deklaruar fajtorë kërkuesit Tom Mamli dhe Enrik (Elton) Mamli, duke i dënuar ata përfundimisht me 29 dhe 22 vjet burgim për veprat penale sipas dispozitivit të vendimit. Vendimmarrja e gjykatës së shkallës së parë është mbështetur në arsytimin se pavarësisht pretendimeve të secilës palë për t'u vendosur në pozitat e mbrojtjes së nevojshme karshi palës tjetër, është e provuar se të dyja palët kanë qenë shkaktare dhe iniciuese të konfliktit, si dhe përgjegjëse për pasojat e shkaktuara në vendngjarje. Gjykata ka çmuar se kërkuesi Tom Mamli, me veprimet e tij të kundërligjshme, ka konsumuar elementet e veprave penale të cituara në dispozitivin e vendimit, pasi ka shkaktuar vdekjen e shtetasit N. T., në një ambient publik, në mënyrë të rrezikshme për jetën e shumë personave të tjerë, fakt ky i provuar në bazë të provave të administruara. Po sipas gjykatës, edhe kërkuesi Enrik (Elton) Mamli ka konsumuar elementet e veprave penale të sipërcituara, pasi ka shkaktuar plagosjen e disa shtetasve në një ambient publik, në mënyrë të rrezikshme për jetën e disa personave dhe pasoja ekstreme e vrasjes nuk ka ardhur për shkaqe që nuk lidhen me vullnetin e tij (*shih faqet 26 dhe 27 të vendimit nr. 214-14, datë 01.02.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin*).

21. Gjykata e apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke mbajtur qëndrim të njëjtë me të. Në bazë të tërësisë së provave të shqyrtuara në gjykim, gjykata e apelit ka çmuar se nuk qëndron pretendimi i mbrojtjes së kërkuesve se ka qenë pala tjetër që ka filluar sulmin, pasi kanë goditur të parët makinën dhe kërkuesit kanë qenë të detyruar të mbrohen, pasi të dyja palët kanë qenë shkaktare dhe nismëtare të konfliktit, si

dhe përgjegjëse për pasojat e shkaktuara në vendngjarje. Gjykata e apelit ka vlerësuar se të dy kërkuesit kanë konsumuar elementet e veprave penale për të cilat janë dënuar. Për sa i përket veprës penale të mbetur në tentativë, gjykata e apelit ka çmuar se pasoja ekstreme e vrasjes nuk ka ardhur për shkaqe që nuk lidhen me vullnetin e kërkuesit Enrik (Elton) Mamli (*shih faqet 25 dhe 26 të vendimit nr. 2475, datë 21.11.2018 të Gjykatës së Apelit Tiranë*).

22. Në vijim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vlerësuar se gjykatat më të ulëta kanë mbajtur qëndrim të njëjtë lidhur me provueshmërinë e fakteve penale në ngarkim të kërkuesve, duke arritur në përfundim të njëjtë lidhur me fajësinë e tyre për kryerjen e veprave penale. Në shqyrtim të shkaqeve të rekursit të paraqitura nga kërkuesit lidhur me provueshmërinë e fakteve penale për të cilat janë deklaruar fajtorë, Kolegji Penal ka vlerësuar se gjykata e apelit ka arritur në përfundim të drejtë lidhur me praninë e elementeve të veprave penale, për të cilat janë vënë nën akuzë të pandehurit dhe se provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm kryeja e këtyre veprave nga kërkuesit. Sipas Kolegjit Penal, pretendimet e kërkuesve lidhur me veprimet e realizuara në kuadrin e kushteve të mbrojtjes së nevojshme ose të tronditjes së rëndë psikike nuk qëndrojnë për sa kohë ato nuk janë pasojë e errësimit të ndërgjegjes, por rezultat i elementit volitiv, dashjes për të kryer veprën penale. Kolegji Penal i ka vlerësuar të pabazuara edhe pretendimet e kërkuesve për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë dhe për pavlefshmërinë e vendimit të gjykatës së apelit, si një vendim i paarsyetuar, pasi ai nuk ka konstatuar shkelje të këtyre parimeve dhe standardeve kushtetuese që cenojnë procesin e rregullt ligjor.

23. Në përfundim, referuar të gjitha shkaqeve të ngritura në rekurs, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka çmuar se nuk konstatohet zbatim i gabuar i ligjit penal material apo procedural nga ana e gjykatës së apelit, me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; nuk konstatohen shkelje me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave apo shkelje të tilla procedurale që të kenë ndikuar në dhënien e vendimit; nuk evidentohet që vendimmarrja e gjykatave të faktit të jetë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) ka vlerësuar se nuk verifikohet asnjë prej rasteve të parashikuara nga neni 432 i KPP-së (*shih paragrafët 29 dhe 31 të vendimit nr. 00-2024-450, datë 12.03.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

24. Për sa më lart, Kolegji vëren se kërkuesit kanë pasur mundësi të paraqesin lirisht pretendimet e tyre për sa u përket provave të marra nga organi i prokurorisë dhe atyre të administruara gjatë gjykimit të çështjes nga gjykatat e faktit, si dhe për çështjet ligjore të analizuara nga Gjykata e Lartë. Po kështu, në garantim të së drejtës së tyre për akses, gjykatat

e juridiksionit të zakonshëm kanë marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuësve, duke i vlerësuar ato përkundrejt parashikimeve ligjore dhe garancive kushtetuese, si dhe kanë dhënë përgjigje të arsyetuar në lidhje me to. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit dhe ka vlerësuar shkaqet e rekursit dhe bazueshmërinë e tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Ai ka krijuar bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara dhe brenda funksionit të tij kushtetues, si gjykatë ligji, ka vendosur në pajtim me kërkesat ligjore mospranimin e rekursit, pa cenuar të drejtën e aksesit të kërkuësve.

25. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese dhe referuar në tërësi përmbajtjes së vendimeve gjyqësore objekt kërkesë, Kolegji vlerëson se gjykatat e faktit i kanë pasqyruar dhe analizuar në mënyrë të plotë rrethanat e çështjes, si dhe i kanë deklaruar fajtorë dhe më pas dënuar kërkuësit, duke i arsyetuar vendimet e tyre bazuar në një sërë provash të administruara në gjykim, të shqyrtuara dhe vlerësuara prej tyre në tërësi e në harmoni me njëra-tjetrën, duke përmbushur elementet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Edhe vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë paraqitet i rregullt në formë, i qartë, koherent dhe pa kundërrënie në përmbajtje. Ai pasqyron rrethanat e çështjes, pretendimet e ngritura në rekurs, vendimmarrjen e gjykatave të faktit, ligjin e zbatueshëm, si dhe arsyetimin e vlerësimin për çështjen. Arsyetimi i kufizuar i vendimit të Gjykatës së Lartë është në përputhje me standardet e Gjykatës për këto lloj vendimesh, duke përmbushur kriteret në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

26. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuësve për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë

27. Kërkuësit kanë pretenduar se gjykatat e faktit janë bazuar në indicie dhe jo në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për deklarimin fajtorë të kërkuësve. Po sipas kërkuësve, edhe në rrjedhën kronologjike të veprimeve të analizuara nga to, nuk ekziston ndonjë provë e drejtpërdrejtë që lidh kërkuësit me veprën penale të kryer. Kërkuësit kanë parashtruar se nga përmbajtja e vendimeve të kundërshtuara, më së shumti, ekziston një dyshim dhe për të justifikuar vendimet e tyre gjykatat e faktit i kanë çmuar pretendimet e kërkuësve si të pabazuara, duke e kaluar barrën e provës nga organi i akuzës te kërkuësit.

28. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Në jurisprudencën e Gjykatës është

pranuar se parimi i prezumimit të pafajësisë ka kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri e ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që deklarimi i fajësisë së të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në gjykim (*shih vendimet nr. 13, datë 24.04.2018; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se nga përmbajtja e vendimit të gjykatës së shkallës së parë rezulton se gjatë shqyrtimit gjyqësor janë administruar dhe analizuar prova të ndryshme, përfshirë këtu akte ekspertimi teknike, teknike balistike, balistike vlerësuese e krahasuese, daktiloskopike, mjeko-ligjore, kimike dhe biologjike, si dhe janë pyetur një sërë dëshmitarësh, duke evidentuar arsyet se përse gjykata ka arritur në përfundimin se kërkuesit janë deklaruar fajtorë. Në gjykim është provuar kryerja e veprave penale për të cilat ata akuzohen, si dhe është arsyetuar përse gjykata ka krijuar bindjen për fajësinë e tyre. Gjithashtu, gjykata e apelit ka analizuar dhe vlerësuar pretendimet e kërkuesve, si dhe provat e paraqitura në gjykim. Në këtë kontekst Kolegji konstaton se kjo gjykatë i ka deklaruar fajtorë kërkuesit pas një shqyrtimi të plotë të çështjes mbi një sërë provash të administruara në gjykim dhe të shqyrtuara e vlerësuara prej saj në tërësi dhe në harmoni me njëra-tjetrën.

30. Referuar standardeve të mësipërme, si dhe arsyetimit të vendimeve të gjykatave, Kolegji çmon se nuk rezulton që këto të fundit të kenë nisur procesin me paragjykimin dhe prezumimin se kërkuesit janë fajtorë për kryerjen e veprave penale për të cilat janë gjykuar.

31. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se edhe pretendimi për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është haptazi i pabazuar.

32. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.